



A.nr.152/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Hava Fekaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.152/2026, të datës 09.02.2026, të parashtruar nga ankuesi F.A, nga Gjilani, kundër organit të punësimit/Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë, në çështjen juridike “*Kontestim Konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ***shpallet jo kompetent*** për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.152/2026, të datës 09.02.2026, të parashtruar nga ankuesi F.A.

II. Çështja bie në kompetencë të Gjykatës kompetente.

A r s y e t i m

Ankuesi, F.A (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 09.02.2026 ka parashtruar ankesë nëpërmjet postës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të Komisionit të Ankesave të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë të datës 21.01.2026, përmes së cilit i është refuzuar ankesa e parashtruar me datë 15.01.2026 kundër procedurës së rekrutimit të shpallur sipas konkursit me Nr.01/5/9179 të datës 15.12.2025 nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë për pozitën: “*Nëpunës/e teknik dhe mbështetës/e*”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.02.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ndërsa kjo e fundit me datë 16.02.2026, ka dorëzuar përgjigjën me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.152/2026, të datës 09.02.2026, të parashtruar nga ankuesi F.A, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë më datë 15.12.2025, ka shpallur konkurs për pozitën e punës *'Nëpunës/e teknik dhe mbështetës/e' I pozite*, në me kohë të caktuar, në Departamentin e Administratës së Përgjithshme, me afat aplikimi nga data 26.12.2025, deri më datë 30.12.2025.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rrjedhë se në konkursin përkatës ka aplikuar edhe ankuesi se të gjithë njëjtë i ka plotësuar kriteret e konkursit dhe ka hyrë në listë të ngushtë, ku i njëjti ka marrë pjesë edhe fazat tjera të vlerësimit profesional, mirëpo sipas Njoftimit të datës 06.01.2026 për kandidatin fitues të publikuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, rezultoi se ankuesi ka arritur 70.03 pike të përgjithshme, duke u renditur i dyti në listë ndërsa kandidati A.M është renditur i pari në listë me gjithsej 77.33 pike të përgjithshme dhe i njëjti është zgjedhur kandidat fitues për pozitën e punës *'Nëpunës/e teknik dhe mbështetës/e'*.

Ankuesi F.M i pakënaqur me procesin e vlerësimit dhe zhvillimit në përgjithësi të procedurës së rekrutimit për pozitën e punës *'Nëpunës/e teknik dhe mbështetës/e'* më datë 13.01.2026 kishte parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë, ndërsa Komisioni i Ankesave i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë më datë 21.01.2026, kishte nxjerrë Vendim me numër protokoli 423 përmes së cilit i refuzoi ankesën e parashtruar kundër konkursit me Nr.01/5/9179 të datës 15.12.2025, për pozitën: *'Nëpunës/e teknik dhe mbështetës/e'*.

Ankuesi i pakënaqur me Vendim me numër protokoli 423 të datës 21.01.2026 të Komisionit i Ankesave të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë më datë 09.02.2026 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin se i njëjti është nxjerrë përmes një procedure tendencioze dhe e përcjellë me parregullsi profesionale dhe ligjore, ashtu që ankuesi kërkon shfuqizimin e këtij vendimi si dhe në të njëjtën kohë kërkon anulimin e konkursit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këto rrethana, respektivisht lidhur me statusin e ankuesit si dhe në kuptim të pranushmërisë së ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat Publike, përkatësisht nenit 5 paragrafi 2 dhe 3 ku përcaktohet se: **"2. Nëpunësja/i i shërbimit civil** është zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunës/e/s statusi i të cilit është përcaktuar si

nëpunës/e i shërbimit civil, me ligj të veçantë” 3. *Nëpunësja/i* i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. *Nëpunësja/i* i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. *Nëpunësja/i* i shërbimit publik është edhe *nëpunësja/i* i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës, ndërsa në paragrafin 5 të këtij neni përcaktohet se: “5. ***Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës*** është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike”, andaj në bazë të shpalljes së konkursit të datës 15.12.2025 rezulton se konkursi është shpallur për pozitën e punës ‘*Nëpunës/e teknik dhe mbështetës/e*’, andaj pozita në të cilën ka aplikuar ankuesi nuk hyn në kategorinë e nëpunësve civil gjegjësisht kjo pozite është **kategorizuar si nëpunës teknik dhe mbështetës..** sikurse përcaktohet me nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe paragrafi 5 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Ndërlidhur me këtë pjesë e **VIII** e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ka trajtuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien e punës së ***nëpunës/it teknik dhe mbështetës***, ku theksohet se marrëdhënia e punës ndërmjet institucionit dhe nëpunës/it teknik dhe mbështetës rregullohet me legjislacionin e punës, andaj mbi këtë bazë dhe duke ju referuar dispozitave të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe pas konstatimit se ankuesi nuk e ka statusin e Nëpunësit Civil dhe kandidatit për Pranim në Shërbimin Civil, Kolegji i Këshillit vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën me numër ankesën A.nr.152/2026 të datës 09.02.2026, të parashtruar nga ankuesi F.A, sepse Këshilli shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

Në kuptim të udhëzimit të palës ankuese lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji vë theksin tek neni 8 i Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërlidhur me nenin 27 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se : *Nëpunësi i shërbimit publik dhe nëpunësi teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë tek Komisioni i Ankesave i themeluar nga punëdhënësi, për çdo veprim apo mosveprim që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme që burojnë nga marrëdhënia e punës. Qeveria pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratë publike, me akt nënligjor përcakton procedurën dhe rregullat për themelimin, përbërjen dhe mandatin e Komisionit të Ankesave, pra, zyrtarët publikë të kategorisë së shërbimeve publike dhe të kategorisë administrative mbështetëse si dhe kandidatëve për pranim në kuadër të këtyre kategorive të pozitave të zyrtarëve publik, në rast të pretendimeve për shkelje të të drejtave të tyre nga marrëdhënia e punës apo procedura e pranimit, fillimisht mund të parashtrojnë ankesë tek punëdhënësi i cili themelon një Komision të Ankesave në pajtim me kërkesat ligjore, e më pastaj, duke ju referuar përcaktimeve ligjore sipas nenit 77 dhe 88 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, mund të ushtrojnë padi në gjykatën kompetente në pajtim edhe me dispozitat e Ligjit 03/L-212 të Punës, respektivisht nenit 78 ku theksohet se: “1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në*

afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. 3. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh.” , dhe nenit 79 i cili përcakton se: “Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.” Andaj në këtë kuptim **nëpunësit teknik dhe mbështetës** dhe kandidatët për pranim në kuadër të kësaj kategorie fillimisht duhet të ankohen te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në Gjykatën kompetente.

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenin 6 paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli nuk është kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.152/2026 të datës 09.02.2026, të parashtruar nga ankuesi F.A, sepse Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbim Civil.

Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.152/2026 të datës 09.02.2026, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesi ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative udhëzon palën ankuese për ushtrimin e mjeteve juridike në Gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë– Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.152/2026

Hava FEKAJ

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Procesmbajtëse

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit F.A;
- Menaxheres së Personelit në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së